



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
SEKTORI I PROKURIMEVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ . 2024

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitimi i kanalit ujitës të tokave bujqësore Sasaj-Lukovë-Shën Vasil”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45247111-1 Punime ndërtimi për kanale ujitëse

VLERA E FONDIT LIMIT: 61,736,547 (Gjashtë dhjet e një milion e shtatëqind e tridhjet e gjashtë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) Lek pa TVSH.

Perlogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë,

OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur/fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 3,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*

v. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NP-1** Punime germimi ne toke **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NP-7** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

** Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Sipas preventivi zërai numer 1 , 2 , 3	Klasifikim A (0 - 20 milione lekë)	
NP- 7	Ujesjelles,gazsjelles, vajsjelles, vepra kullimi e vaditje	Sipas preventivi nga zërai numer 4 deri 21	Klasifikim A (0 - 20 milione lekë)	
N.S-18	Punime topogjeodezike	Sipas projektit dhe specidikeimeve	Klasifikim A (0 - 20 milione lekë)	

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- Certifikate ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikate ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.

Certifikate ISO 45001-2018 “Per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune”, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mesiperme sipas natyres së punimeve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kërkesa për keto certifikata është bere pasi janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2015 - Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

ISO 45001: 2018 – Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

ISO 14001-2015- Është standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Rikonstruksioni i objektit konkret, përveçse kërkon një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen si ndotja e ajrit nga pluhurat e kantierit ndotja akustike dhe mjedisore nga makinerite etj, aq me teper që kemi të bëjmë me dy objekte brenda në qytet. Për këtë arsye çdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e ambientit. Është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

Argumentimi : Kërkesat e mesiperme janë vendosur në zbatim të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 date 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtyre kriterëve ka patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë kryerjes së punimeve, faktin që objekt i këtij prokurimi ka punime ger mimi etj, Gjithashtu bazur në Ligjin Nr.10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, është kërkuar të disponojë këto licence me qëllim për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe të sigurojë mekanizimin mjedisor të mbetjeve neni 57.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.A - “Vlerësimi

i ndikimit në mjedis. Auditimi mjedisor”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), të vlefshme.

Argumentimi : Kerkesat e mesiperme jane vendosur ne zbatim te ligjit 162/2020 Per prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 date 19.05.2021 “ Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **55** (*pesedhjete e pese*) **punonjës** për periudhën **3** (*tre*) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafii menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 65 (gjashtedhete e pese) punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë,drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe nëKreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë*

kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi (Profili Gjeoteknik)**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mjedisi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeolog**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshtatur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e

kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashatrojmë: është kërkuar inxhinier hidroteknik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve voluminoze hidraulike lidhur

me zërat e preventivave të punimeve seksioni “Punime hidroteknike”, Zbatimi i projektit nuk duhet të ketë pasoja negative në mjedisin e zonës. Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis dhe gazrave në ajër, për kanalet e drenazhimit të ujërave, rreth perimetrit të zonës së punimeve , është kërkuar Inxhinier Ndërtimi (Profili Gjeoteknik) i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: punime betoni , kalim ure , prize sifon etj është kërkuar gjeodet/topograf, pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, është parashikuar se kontraktori që do të marrë përsipër zbatimin e objektit inxhinierik, duhet të bëjë dendësimin e pikave të bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit, në lidhje me saktësinë e realizimit të piketimit , është kërkuar Inxhinier Mjedisi në mënyra për të zgjidhur problemet që lidhen me mjedisin. Ai është i nevojshëm për mbrojtjen e mjedisit, si kontrolli i ndotjes së ajrit dhe ujit, riciklimi dhe asgjësimi i mbeturinave. është kërkuar Inxhinier Gjeolog per shkak se punimet do te kryhen ne nje zone e cila nuk eshte e qendrueshme dhe mund te kete rreshqitje te dherave.

Nga shoqëria kërkohet dhe një azhornim i saktë i këtij investimi në përfundim.

- b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit te punimve, si më poshtë:
- Inxhinier Hidroteknik me diplome të nivelit të parë – jo më pak se **1 (një)** punonjës
 - Teknik topograf hidroteknik – jo më pak se **1 (nje)** punonjës
 - Teknik hidraulik – jo më pak se **1 (një)** punonjës
 - Saldator – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
 - Hekurthyes - jo më pak se **2 (dy)** punonjës
 - Kaperntier - jo më pak se **5 (pese)** punonjës
 - Betonues – jo më pak se **8 (tete)** punonjës
 - Kopshtar – jo më pak se **1 (një)** punonjës
 - Punonjes pergatites te konstruksioneve metalike – jo më pak se **1 (një)** punonjës
 - Suvatues – jo më pak se **2 (dy)** punonjës

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht per periudhen Qershor 2024 - Gusht 2024.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit per

diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me siper.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Argumentimi : Janë kërkuar punonjës të specializuar dhe të certifikuar, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm, sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën; Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetëror, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht janë kërkuar:

- **Inxhinier Hidroteknik** me diplome të nivelit të parë, të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve hidroteknike të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës dhe nga që kanali ka një shtrirje të gjatë në tre fshatra dhe nuk mund ta ndjek një inxhinier i vetëm.
- **Teknik topograf hidroteknik**, janë të nevojshme për zbatimin e saktë të kuotave të objektit që do të ndërtohet, në funksion të realizimit të saktë të tij, si dhe realizimin e punimeve gjeodezike, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.
- **Teknik hidroteknik** të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve hidroteknike të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.
- **Saldator**
- **Hekurthyes** të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve të hekurit të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.
- **Specialistët karpentier, betonues** të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve të armatures dhe betonit të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

- **Kopshtar** të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet prerje bimesie e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike
- **Punonjes pergatites te konstruksioneve metalike** të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike
- **Suvatues** të cilët janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike

Kërkesat e mësipërme bazohen në pikën 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) inxhinier të certifikuar (inxhinier mjedisi ose staf me kualifikim te ngjashem) si “Pergjegjes për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë , në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10431 datë 09/06/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata shqiptar ose i huaj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 *Punonjes* të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” gjatë kryerjes së veprimtarisë , në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10431 datë 09/06/2011 “Për

mbrojtjen e mjedisit” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/çertifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. OE ofertues referuar Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësin që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek .

- f) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1 (një)** punonjës që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”**, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST,

si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune dhe çertifikatë përkatëse.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. për shkak të natyrës së punimeve që kryhen të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e punonjesve të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

g) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë notoriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies

së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuasi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuësve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- 8 (tete) Punonjes Manovratore/Eskavatoriste ,
- 5 (pese) Punonjes Manovratore/Automakiniste,
- 1 (nje) Punonjes Manovratore/Buldozerist,

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të perkojë me kërkesat e profilit të deklaruar për çdo punojes.
- Të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt

kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punës, datën e kontratës së punës, numrin e deshmisë së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmerisë së saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atëherë eskavatorist / buldozerist, automakinist, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon të drejtën e verifikimit të deklarimeve për punonjësit e mesiperm, çdo informacion i rreme apo i devijuar nga kërkesat e mesiperme do të jetë kusht për skualifikimin e ofertes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferët janë të nevojshëm për shkak të makinerive të ndryshme që do të kryejnë punime germimi, ngjeshje materiali etj.

2.3.9 (Makineri, Pajisje)

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr	Makineri dhe pajisje	Gjendja	Sasia
1	Eskavator me goma MT	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Fadrome me goma MT	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Minifadrome me goma MT	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Autobetoniere kantieri 2.5-3.5 m ³	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Eskavator me krah të gjatë mbi 18 ml	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Kamion vetshkarkues (kapaciteti mbajtës nga 3.5-ton deri në 5 ton)	në pronësi ose me qira	Copë 3
8	Pajisje topografike GPS	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Vibrator betoni i jashtëm	në pronësi ose me qira	Copë 4
10	Tokmak	në pronësi ose me qira	Copë 4
11	Buldozer	në pronësi ose me qira	Copë 1

12	RTV - Transportier per mjete te renda mbi 15 ton pesha mbajtese (per perdorim te vecant)	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Moto gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Damper kantieri	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Cekic per prishje betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Paisje per largimin e ujerave nentoksore me sistem gjilperthithese (Sistemi Well Point i paisur me pompe thithese,age ,kolektor dhe aksesor bashkues) thithese + tuba	në pronësi ose me qira	Copë 1

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 55 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 3 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 3 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 30 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për paisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për paisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata*

dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) dhe Foto e dukshme të pajisjes/makinerisë (të paktën 1).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme gjeografike, prandaj do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht, për të kapur afatet e përcaktuara. Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

1. Eskavator me goma MT është I nevojshem per punimet e germimit.
2. Fadrome me goma MT eshte e nevojshme per punimet e germimit dhe mbushjes me materialin e germuar me pare.
3. Minifadrome me goma MT eshte e nevojshme per levizjen e materialeve dhe sistemimeve.
4. Autobetoniere kantieri 2.5-3.5 m3 eshte e nevojshme per prodhimin e betonit sipas kerkesave te projektit dhe preventivit.
5. Eskavator me krah të gjate mbi 18 ml eshte i nevojshem per punimet e germimit ne distance , dhe me qe ne shume vende nuk ka rruge jemi te detyruar te perdorim eskavatorin me krahe te gjate .
6. Kamion me vinc eshte i nevojshem per transportin e cimentos dhe materjaleve te tjera qe nevoiten ne object .
7. Kamion vetshkarkues (kapaciteti mbajtës nga 3.5- ton deri ne 5 ton) nevoitet per transportin e materjaleve per punonjesit ne objekt .
8. Paisje topografike GPS nevoitet per matejet gjeodezike
9. Vibrator betoni i jashtem eshte i nevojshem per vibrimin e betoneve
10. Tokmak eshte i nevojshem ngjeshjen e kanalit para shtreses se betonit
11. Buldozer eshte i nevojshem per hapjen e rrugeve ku do ndertohtet kanali
12. RTV - Transportier per mjete te renda mbi 15 ton pesha mbajtese (per perdorim te vecant) eshte i nevojshem per transportin e mjeteve ne objekt
13. Moto gjenerator eshte i nevojshem per nevoja te puntoreve
14. Damper kantieri eshte i nevojshem per transportin e inerteve afer kanalit
15. Cekic per prishje betoni eshte i nevojshem thyerjet e objektit
16. Paisje per largimin e ujerave nentoksore me sistem gjilperthithese (Sistemi Well Point i paisur me pompe thithese,age ,kolektor dhe aksesor bashkues) thithese + tuba eshte i nevojshem per largimin e ujerave nga objekti .

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialin Tuba Çeliku sipas specifikimeve teknike dhe projektit .Per materialin e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë CE

ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nënën 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertohen, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës. Gjithashtu OE duhet të paraqesin skedat teknike/katalogë për disa prej artikujve kryesor të objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë secilin lloj të mallit që ofertojnë, për të gjykuar nëse malli që do të lëvrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues. Kërkesa për skedat teknike/katalogë çertifikatë CE ose raportet e testimit është vendosur për pajisjet që kanë një rëndësi të veçantë për AK dhe një vlerë të konsiderueshme.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019

Argumentimi Në bazë të nënës 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 8, të nënës 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri AK gjykon se disponimi në pronësi apo me qera i këtyre fabrikave është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kerkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i garantuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave që do të përdoren në punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit çilesorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kerkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe çilesitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt

me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar,i Preventivin si dhe analizen e cmimeve per zerat e preventivit, (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Ne rast BOE grafikun e punimeve duhet te jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Specifikimet teknike jane hartuar ne zbatim te nenit 36 te ligjit nr.162/2020 “ Per prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

Specifikimet teknike jane hartuar nga inxhinier i licensuar dhe do te bashkengjiten dokumentave te tenderit ne SPE.

NJESIA E PROKURIMIT